# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-457183**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gati për Bjellorusinë! Trajneri Maran publikon listën: Mungon Broja, rikthehet Berisha, objektivi, vendi i parë |
| ADRESA | `https://a2news.com/sport/futboll/gati-per-bjellorusine-trajneri-maran-publikon-listen-mungon-broja--i1185408` |
| BURIMI | a2news.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 09:25:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 09:19:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e1b2776d6ccd487082588c978fe32489409dcb2fc528b48acbe29f597d85f775` |
| TEKSTI | `1591dfdae6ba8da4d52d46fc3d91193c3b528aec18592682f5d9007634ac8b88` |
| PAMJA | `1ce3a19e2927dc90f0687ebedc50869af2b572c9359666b93d23faf795ecab03` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `847813884f5f2c2838e867d12cdc2f51abc0a62e5bad035796f460fe506434e3` |
| E MËPARSHMJA | `6653c7d41cd918b587b053e90c46cf986177283c689055bdd5a9a12c12c821f6` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/847813884f5f2c2838e867d12cdc2f51abc0a62e5bad035796f460fe506434e3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Gati për Bjellorusinë! Trajneri Maran publikon listën: Mungon Broja, rikthehet Berisha, objektivi, vendi i parë

Nga Dea Kozma
19 Shtator 2026, 11:19 | Futboll




Një tjetër kapitull nis për Kombëtaren shqiptare dhe këtë herë me një emër të ri në krye të pankinës. Rolando Maran ka bërë zgjedhjet e tij për katër përballjet e para të UEFA Nations League, ndaj Bjellorusisë, San Marinos dhe Finlandës

Në listen prej 29 lojtaresh te thirrur shfaqen edhe dy emra të rinj. Sabah Kerjota, mesfushori i Hearts, merr për herë të parë ftesën me Kombëtaren A, ndërsa Samuele Sina, mbrojtësi i Union Brescia, është risia tjetër.

Rey Manaj, Ernest Muçi dhe Marash Kumbulla rikthehen pas dëmtimeve që kaluan, ndërsa një tjetër emër me eksperiencë është Etrit Berisha.

Në krahun tjetër, ka edhe emra që këtë herë nuk janë pjesë e listës. Thomas Strakosha mungon, ndërsa nuk janë grumbulluar as Armando Broja dhe as Nedim Bajrami. Këto zgjedhje i japin një tjetër pamje grupit të Maranit, i cili duket se po kërkon të zgjerojë alternativat dhe të krijojë konkurrencë në çdo repart.

Sfida e parë do të jetë në shtëpi, më 26 shtator, ndaj Bjellorusisë. Vetëm tri ditë më vonë kuqezinjtë udhëtojnë drejt San Marinos, ndërsa më 3 tetor përballen me Finlandën në transfertë. Cikli mbyllet më 6 tetor, sërish në Tiranë, me San Marinon.

Grumbullimi nis të hënën, më 21 shtator. Katër ndeshje në vetëm dhjetë ditë, një kalendar intensiv që do t'i japë Maranit mundësinë e parë për të treguar se çfarë Shqipërie kërkon të ndërtojë.. Objektivi mbetet i qartë: vendi i parë në grup.

**Njoftimi i FSHF**

Trajneri Rolando Maran shpall listën për katër ndeshjet e UEFA Nations League, dy debutues dhe rikthime në skuadër

Kombëtarja shqiptare do të nisë rrugëtimin e saj të ri në kompeticionin UEFA Nations League, me katër ndeshjet e para ndaj Bjellorusisë, Finlandës dhe San Marinos, me të cilën do të përballet në dy takime.

Trajneri i Kombëtares, Rolando Maran, ka publikuar listën me 29 lojtarët e grumbulluar për këto sfida. Në listë bëjnë pjesë edhe dy emra që marrin ftesën e parë me Kombëtaren, mesfushori i Hearts, Sabah Kerjota dhe mbrojtësi i Union Brescia, Samuele Sina.

Ndërkohë, në skuadër rikthehen pas mungesave për shkak të dëmtimeve Rey Manaj, Ernest Muçi dhe Marash Kumbulla. Në listë është edhe portieri Etrit Berisha, i cili rikthehet të jetë pjesë e grupit të Kombëtares.

Më poshtë lista e plotë e lojtarëve të grumbulluar:

TE FUNDIT

Qëlloi me armë në ajër dhe plagosi një person, arrestohet 45-vjeçari në Tiranë

Falsifikuan dokumentet për 6 prona në Fier, arrestohen ish-drejtori i ASHK-së dhe përfituesi

Bordi i Transparencës cakton çmimet e reja të karburanteve

Prania Besnike, Rama motivon socialistët: "Keep going" drejt objektivave

MË TË VIZITUARAT

Aneksim jo, mbrojtje me ushtri, çfarë parashikon marrëveshja SHBA-Danimarkë p...

Nafta fik traktorët, fermeri habitet nga çmimi: Po e blejmë njësoj si makinat...

Protestë në Vlorë kundër ndërtimit të muzeut hebraik

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Portierë: Etrit Berisha, Alen Sherri, Mario Dajsinani dhe Simon Simoni.

Mbrojtës: Berat Gjimshiti, Ardian Ismajli, Marash Kumbulla, Klisman Cake, Samuele Sina, Mario Mitaj, Naser Aliji, Stavro Pilo, Elseid Hysaj dhe Ivan Balliu.

Mesfushorë: Kristjan Asllani, Ylber Ramadani, Juljan Shehu, Qazim Laçi, Luis Hasa, Adrion Pajaziti, Arbër Hoxha, Taulant Seferi, Anis Mehmeti, Ernest Muçi dhe Sabah Kerjota.

Sulmues: Rey Manaj, Mirlind Daku, Myrto Uzuni dhe Cristian Shpendi.

Kombëtarja shqiptare nis zyrtarisht grumbullimin ditën e hënë, më 21 shtator, ku do të stërvitet në "Shtëpinë e Futbollit". Biletat për dy ndeshjet ndaj Bjellorusisë dhe San Marinos mund t'i blini online në ebileta.al, si edhe në pikën fizike pranë stadiumit "Air Albania". **(A2 Televizion)**

## A2 CNN Livestream


MUND TE LEXONI GJITHASHTU

Thellohet kriza e Vllaznisë, Teuta tenton "arratisjen" në krye

Tregolësh për Olise, rekord për Kane. Bayern Munchen fiton me goleadë

Tirana Elbasani/ FSHF u mbyll derën tifozëve, Tirana premton "luftë" deri në fund

Çfarë po ndodh te Kosova? Shkon në 4 numri i lojtarëve të tërhequr nga përfaqësuesja

Yjet jashtë dhe rikthimet e bujshme, Spanja dhe Anglia publikojnë listën e lojtarëve të thirrur për Ligën e Kombeve

Sot Europa League me 9 sfida. Vëmendja te Juventusi, në fushë Real Sociedad-Bournemouth

## Latest Videos




Nafta fik traktorët, fermeri habitet nga çmimi: Po e blejmë njësoj si makinat luksoze




Aneksim jo, mbrojtje me ushtri, SHBA dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën




Arabia Saudite nën alarm pas një shpërthimi të fuqishëm në Riad




Prania Besnike, Rama motivon socialistët: "Keep going" drejt objektivave



© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.